

LIGJ

Nr.7811, date 12.04.1994

MBI APROVIMIN E DEKRETIT Nr.782, DATE 22.2.1994 "MBI SISTEMIN FISKAL NE SEKTORIN E HIDROKARBUREVE" "(KERKIM-PRODHIM)"

Ne mbeshtetje te neneve 10 dhe 28 te ligjit Nr.7491, date Per dispozitat kryesore kushtetutese", me propozim te Keshillit te Ministrave.

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Neni 1

Te aprovoje dekretin No.782, date 22.2.1994 "Mbi sistemin fiskal ne sektoret e hidrokarbureve (Kerkim -Prodhim) me ndryshimet e meposhtme:

1. Paragrafi i pare i nenit 1 te Dekretit eshte formuluar si me poshte:

"Kontraktori eshte i detyruar te paguaj cdo vit fiskal vetem taksen mbi fitimin te realizuar gjate vitit fiskal. Taksa e fitimit mund te paguhet me para ne dore apo ne natyre, ose ne te dy format, sic mund te jete shprehur ne marreveshjet hidrokarbure".

2. Paragrafi i dyte i nenit 3 eshte formuluar si me poshte:

"Gjithashtu i njeiti trajtim si ne paragrafet e siperpermendur te perdorimit te mjeteve te perdorimit personal te punonjesve te huaj te kontraktorit dhe nen kontraktoreve te tij, qe kane lidhje me operacionet hidrokarbure".

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi menjehere.

Shpallur me dekretin Nr.825, date 20.04.1994 te Presidentit te republikes se Shqiperise, Sali Berisha